

6. Në bazë të Udhëzimit të Kryeministrit nr 1 datë 04.06.2014, "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshmenë ne llogari të Thesarit", **shuma totale e detyrimeve për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, bëhet pjesë e programit buxhetor** dhe nëse gjatë vitit buxhetorë ka fonde të papërdorura, përpara mbylljes së vitit buxhetorë këto fonde mund të përdoren për aq sa është e mundur për shlyerjen e një pjese të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, duke respektuar rradhën e paraqitjes. Do të vijoj të jete ne qender te vemendjes sone, jo vetem ne pergatitjen e dokumentit te PBA Perfundimtare 2020-2022, por dhe gjate zbatimit te buxhetit 2019.

7. Një vëmëndje e vecant duhet ti kushtohet **qëndrueshmërisë fiskale** si një kërkesë për stabilitetin e bashkisë, dhe krahas njohjes së risqeve që përballet bashkia.


Vëmëndje do ti kushtojmë edhe risqeve që vijnë nga plani i shlyerjes së detyrimeve të konstatuara dhe të papaguara nga marrëveshjet e bashkëfinancimeve, si dhe ndryshimet buxhetor që kryhen gjatë viti.

Në zbatim të Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 38, *procsverbalet e dëgjesave publike si dhe lista e pjësuarreseve janë pjesë e dokumentave të përgatitjes dhe miratimit te PBA 2020-2022.*

Tavanet Përfundimtare të PBA 2020-2022, përgatitur bazuar në instrumentin e planifikimit financiar dhe ndarjes në nënfunksiione sipas modelit te dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, nuk kanë ndryshime nga tavanet përgatitore miratuar me VKB nr.51 date 19.03.2019.

Faleminderit për bashkëpunimin!

KRYETARI I BASHKISË (NA)

Ervin DEMO


DREJTORE FINANCES (NZ)

Luiza BAZAJ




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

PROJEKTVEKNDIM

PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2020-2022 TË RISHIKUAR

Kryetari i Bashkisë pasi u njoh me materialin, Programi Buxhetor Afatmesëm (i rishikuar) 2019-2021 , mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni8/2, neni 41, neni 54 gërma “dh”, neni 64 gërma “c”; ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar ; ligjin 68 /2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 38; Udhëzimin e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së pogramit buxhetor afatmesëm të njësive të qeverisjes vendore” dhe Udhëzimin e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr.7, datë 27.02.2019 ‘Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesem 2020-2022”

PROPOZON:

1. Të miratoj programin buxhetor afatmesëm 2020-2022 të rishikuar, hartuar sipas Instrumentit të Planifikimit Financiar pasqyra D1, bashkëlidhur.
2. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Grupi për Menaxhim Strategjik.

KRYETARI I BASHKISË

Ervin Demo



Projektvendim u pa dhe ka bazueshmëri ligjore .

JURISTE

Nertila KADËNA

SEKRETARE E KESHILLIT BASHKIAK

Bora AGALLIU